



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.621/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Bujar Muzaqi dhe Violeta Husaj-Rugova, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të refuzimit të disa zarfeve me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosove, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 28.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Hedhet e palejuar ankesa Anr.621/2025 e datës 27.02.2025, e paraqitur nga Subjekti Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të refuzimit të disa zarfeve me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosove, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Më datë 27.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Subjekti Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilën theksohet se në mbledhjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të datës 25.02.2025, Sekretariati i KQZ, ka paraqitur Raportin e aktiviteteve të kryera nga SKQZ. Një ndër pikat e këtij Raporti (pika 4) ishte edhe "Vlerësimi i zarfeve me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovës". Nga vlerësimi i 68,990 zarfeve, SKQZ ku konstaton në pikën b) se 4,865 zarfe janë refuzuar. Më tutje në ankesë theksohen arsyet e refuzimit të 4,865 zarfeve, janë; a) 2,870 zarfe nuk janë proceduar, pasi votuesit ishin të anuluar gjatë fazës së aplikimit për regjistrim si votues jashtë Kosovës (29 gusht 2024-26 dhjetor 2024), b) 310 zarfe janë refuzuar, pasi fletëvotimi nuk ka qenë i personalizuar (një person-një fletëvotim), c) 24 zarfe janë refuzuar, pasi nuk kanë pasur pullë/vulë postare, d) 138 zarfe janë refuzuar, pasi votuesit i kanë dërguar nga një shtet tjetër nga ai që kishin deklaruar gjatë regjistrimit, e) 178 zarfe janë refuzuar, pasi brenda tyre ka qenë vetëm dëftesa e regjistrimit, pa fletëvotim, f) 432 zarfe janë refuzuar, pasi brenda tyre ka munguar dëftesa e regjistrimit dhe kanë përmbajtur vetëm fletëvotimin, g) 45 zarfe janë refuzuar, pasi votuesit kanë dërguar fletëvotimin me dokument identifikues të Kosovës dhe nuk kanë përfshirë dëftesën e regjistrimit, h) 868 zarfe janë refuzuar, pasi votuesit kanë dërguar zarfin me fletëvotim më shumë se një herë. Në vazhdim të ankesës theksohet se bazuar në raportin e SKQZ, kategoritë e zarfeve të refuzuara sipas pikës a) 2,870 zarfe, pika c) 24 zarfe, pika e) 178 zarfe, pika f) 432 zarfe, dhe pika h) 868 zarfe, janë refuzuar me të drejtë, sepse janë zarfe me të meta që cenojnë ligjin dhe rregulloret e KQZ në lidhje me votimin me postë. Ndërsa sipas këtij Raporti, kategoritë e zarfeve të refuzuara sipas pikës: b) 310 zarfe nuk janë proceduar, pasi votuesit ishin të anuluar gjatë fazës së aplikimit për regjistrim si votues jashtë Kosovës (29 gusht 2024-26 dhjetor 2024); pika d) 138 zarfe janë refuzuar, pasi votuesit i kanë dërguar nga një shtet tjetër nga ai që kishin deklaruar gjatë regjistrimit; pika g) 45 zarfe janë refuzuar, pasi votuesit kanë dërguar fletëvotimin me dokument identifikues të Kosovës dhe nuk kanë përfshirë dëftesën e regjistrimit. Ka theksuar se kategoria e dytë e fletëvotimeve është shteti ndryshe nga ai i regjistrimit dhe pretendojnë se KQZ sërish për shkak të

konkretisht nuk i ka vlerësuar ato, për shkak se votuesi që jeton jashtë shtetit ka votuar nga një shtet tjetër, ndryshe nga shteti ku është regjistruar. Sipas parashtruesit të ankesës me refuzimin e vlerësimit të këtyre zarfeve është shkelur e drejta për të votuar e cila është e drejtë edhe kushtetuese edhe ligjore, duke përfshirë edhe të drejtën e lëvizjes së njerëzve nga një shtet në shtetin tjetër si kategori kushtetuese, dhe se konsiderojnë se në asnjë rrethanë nuk është cenuar ose keqpërdorë e drejta e votës vetëm pse dërgimi i zarfeve me fletëvotime është bërë nga një shtet tjetër ndryshe nga shteti ku shtetasi është regjistruar. Lidhur me Kategorinë e tretë-më shumë se një fletëvotim theksohet se KQZ, ka miratuar Procedurat Standarde të Veprimit, Regjistrimi dhe Votimi jashtë Kosovës, si dhe Vlerësimi i Pakove me Fletëvotime. Në ankesë theksohet se në këtë dokument me efekt juridik, Divizioni i Teknologjisë Informative Zgjedhore, konkretisht në pikën 1.1.6, lejon që të bëhen deri në 4 kërkesa familjare për regjistrim përmes një emaili dhe kësisoj KQZ, i ka refuzuar zarfet që kanë përmbajtur fletëvotime të më shumë personave në një zarf. Sipas parashtruesit të ankesës KQZ, nuk ka bërë njoftim të duhur dhe të saktë orientues dhe kësisoj votuesit jashtë Kosovës duke e ditur se procedurat e lartpërmendura në një dokument të vetëm kanë përcaktuar se lejohet kërkesat familjare për regjistrim përmes një emaili deri në 4 kërkesa për familje, natyrisht që votuesit jashtë vendit, sidomos votuesit me përbërje familjare kanë vendosur që brenda një zarfi të vendosen 4 fletëvotime dhe kësisoj të dërgohen në kutitë postare të hapur nga KQZ, jashtë vendit. Si dhe lidhur me kategorinë e katërt- fletëvotimi me dokument të Kosovës, parashtruesi në ankesë thekson se në procedurat standarde të KQZ, të miratuara nga vet KQZ, "Votimi përmes postës" përcaktohet saktë se "në emailin njoftues të KQZ-së, lidhur me aprovimin e kërkesës për regjistrim, shtetasi duhet të pranojë dëftesën e regjistrimit dhe dëftesa e regjistrimit duhet të printohet dhe së bashku me zarfin e fshehtësisë, i cili përmban fletëvotimin të vendoset në zarfin kryesor, në të cilin shënohen të dhënat e kutisë postare të KQZ-së". Mirëpo, në disa raste KQZ, ka dështuar të ia dërgojë dëftesën e regjistrimit shtetasit që jeton jashtë vendit, dhe kësisoj, shtetasi së bashku me fletëvotimin ka vendosur kopjen e letërnjoftimit, dhe ka dërguar në kutinë postare. KQZ, ka refuzuar zarfet e tilla dhe njëkohësisht nuk i ka vlerësuar ato dhe kjo ka ndodhur edhe si pasojë e informimit të pamjaftueshëm. Sipas pretendimeve në ankesë të gjitha këto zarfe janë refuzuar në mënyrë jo të drejtë, pa fajin e votuesve, kryesisht për shkak të informimit jo të duhur, informimit jo të qartë, dhe të mangët nga vetë KQZ. Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i, që të urdhërojë KQZ-në, që t'i vlerësojë dhe t'i numërojë zarfet me fletëvotime sipas legjislacionit në fuqi.

Në përgjigjen në ankesë të pranuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), më datë 27.02.2025 KQZ, theksohet se, Divizioni i Shërbimit Votues, nga data 9 shkurt 2025 deri më 25 shkurt 2025, ka kryer vlerësimin e zarfeve me fletëvotime të pranuar nga kutitë postare të KQZ, në përputhje me "Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime" të miratuar nga KQZ, gjegjësisht pikës 2.6, Rregulloren Zgjedhore 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, nenin 18, pika 4.1 si dhe Rregulloren Zgjedhore 17/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, nenin 18, paragrafi 4. Pas përfundimit të këtij aktiviteti KQZ, ka hartuar raportin informues, lidhur me vlerësimi i zarfeve me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovës, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 9 shkurt 2025, të cilin e ka prezantuar në kuadër të aktiviteteve të Sekretariatit të KQZ-së, në mbledhjen e KQZ-së, Nr.16/2025 të datës 25.02.2025. Nga ky raport rezulton se nga 68,712 zarfe të dërguara në kutitë postare të KQZ: a) 62,990 zarfe janë aprovuar, b) 4,865 zarfe janë refuzuar, c) 131 zarfe kanë mbërritur gabimisht në adresën e KQZ (në kutitë postare), 729 zarfe nuk janë vlerësuar, pasi aplikuesit kishin zgjedhur të votonin fizikisht në përfaqësitë diplomatike dhe për vlerësimin e këtyre zarfeve, është e nevojshme skanimi i listës së votuesve të përfaqësive diplomatike, për të mundësuar krahasimin dhe shmangien e votimit të dyfishtë. Në vazhdim të përgjigjes theksohen arsyet e refuzimit të 4,865 zarfeve: a) 2,870 zarfe nuk janë proceduar, pasi votuesit ishin të anuluar gjatë fazës së aplikimit për regjistrim si votues jashtë Kosovës (29 gusht 2024-26 dhjetor 2024), b) 310 zarfe janë refuzuar, pasi fletëvotimi nuk ka qenë i personalizuar (një person-një fletëvotim), c) 24 zarfe janë refuzuar, pasi nuk kanë pasur pullë/vulë postare, d) 138 zarfe janë refuzuar, pasi votuesit i kanë dërguar nga një shtet tjetër nga ai që kishin deklaruar gjatë regjistrimit, e) 178 zarfe janë refuzuar, pasi brenda tyre ka qenë vetëm dëftesa e regjistrimit, pa fletëvotim, f) 432 zarfe janë refuzuar, pasi brenda tyre ka munguar dëftesa e regjistrimit dhe kanë

dokument identifikues të Kosovës dhe nuk kanë përfshirë dëftesën e regjistrimit, h) 868 zarfe janë refuzuar, pasi votuesit kanë dërguar zarfin me fletëvotim më shumë se një herë.

Kategoria e refuzimit-votuesit e paregjistruar për votim jashtë Kosovës: Në këtë kategori, në përgjigje është theksuar se janë 2870 raste refuzimi për shkak se votuesit janë anuluar gjatë procesit të regjistrimit si votues jashtë Kosovës. Kjo ka ndodhur pasi ata janë regjistruar nga një adresë emaili e njëjtë, dhe pas kontaktimit të tyre është lajmëruar një person tjetër (në shumicën e rasteve ka poseduar dëftesat e regjistrimit të personave të regjistruar) ose numri i dhënë ka qenë gabim. Divizioni i Shërbimit Votues ka verifikuar këta votues dhe ka anuluar regjistrimet për ata që nuk kanë dëshmuar se posedojnë dëftesën e regjistrimit (dokumenti i nevojshëm për dërgimin e zarfit me fletëvotim), në përputhje me “Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime” të miratuar nga KQZ, gjegjësisht pikës 2.6. Këta votues janë njoftuar se duhet të aplikojnë nga emaili i tyre personal dhe të mos aplikojnë për persona të tjerë. Ky refuzim nuk lidhet me njoftimet e gabueshme rreth adresave të dërgimit, pasi këto zarfe janë pranuar nga kutia postare të KQZ-së dhe jo nga adresat e përfaqësive diplomatike.

Kategoria e refuzimit-shteti ndryshe nga ai i regjistrimit: theksohet se ky refuzim është bërë në përputhje me Rregulloren Zgjedhore 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, nenin 18, pika 4.1, dhe “Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime.” Votuesi duhet të dërgojë zarfin me fletëvotim nga shteti ku jeton. Refuzimi ka ndodhur për arsye se votuesi gjatë regjistrimit ka zgjedhur shtetin ku jeton, por zarfi me fletëvotim është pranuar nga një shtet tjetër. Divizioni i Shërbimit Votues ka verifikuar këtë kategori dhe ka siguruar që në shtetet ku nuk ka pasur kuti postare të hapur nga KQZ, votuesi ka dërguar zarfin nga shteti i regjistrimit. Në rastet kur zarfi ka pasur vulë/pullë postare nga shteti i regjistrimit, zarfi është aprovuar. Sipas përgjigjes së KQZ, janë refuzuar 138 raste, pasi zarfi ka ardhur nga një shtet tjetër dhe nuk ka pasur pullë postare që do të vërtetonte shtetin e regjistrimit.

Kategoria e refuzimit – më shumë se një person brenda zarfit: Në përgjigje të KQZ-së, ky refuzim është bërë në përputhje me Rregulloren Zgjedhore 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, nenin 18, paragrafi 4, i cili thotë se “Dërgesa postare me fletëvotim është e vlefshme nëse është individuale dhe dërguar nga personi që figuron në listën e votuesve jashtë Kosovës.” Kategoria e refuzimit – fletëvotimi me dokument identifikimi të Kosovës: Theksohet se Divizioni i Shërbimit Votues, ka kryer vlerësimin e zarfeve me fletëvotime në përputhje me rregulloret dhe procedurat e miratuara nga KQZ, të cilat nuk kërkojnë që votuesit të dërgojnë dokument identifikimi gjatë procesit të votimit. Zarfi me fletëvotim duhet të përmbajë dëftesën e regjistrimit, e cila është pranuar në momentin e regjistrimit si votues jashtë Kosovës. Votuesit janë njoftuar për këtë procedurë gjatë regjistrimit. Po ashtu, para periudhës së votimit përmes postës, Departamenti i Teknologjisë Informativë Zgjedhore dhe Shërbim Votues ka dërguar njoftime për çdo aplikues të regjistruar, duke ofruar informacionet e nevojshme për votimin, si dhe duke ridërguar dëftesën e regjistrimit në rast se votuesi ka fshirë emailin. Si dhe në fund të tekstit njoftues, është dërguar një tekst i lidhur me vlefshmërinë e fletëvotimeve dhe me kategoritë e refuzimit të përmendura më sipër. KQZ, kërkon nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), që pretendimet e palës ankuese t’i hedhë si të palejuara dhe të pa bazuara.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, vëren se ankesa është e palejuar.

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohet refuzimit të zarfeve me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovës, po ashtu edhe në përgjigjen në ankesë të KQZ-së konstatohen se këto zarfa janë me fletëvotime të pavlefshme, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimueshëm nga subjektet politike të cilët kanë pretendime në raport me të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ-së.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105.1 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ankesat

brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht” dhe neni 13.3 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi për hedhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejdukon rezultatin përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe 13.3 Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.621/2025 datë 28.02.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.